



NISMA për Kosovën

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2016 - 31 Dhjetor 2016

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së NISMA për Kosovën

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik NISMA për Kosovën (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “NISMA”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2016, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinion të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2016, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç është prezantuar në pasqyrën e Pozitës financiare të bashkëngjitur, SP nuk ka bartur humbjen nga viti i kaluar në vlerë 24, 375.38 Euro me 31 Dhjetor 2016 (19,950.90 euro; 31 Dhjetor 2015) duke nënvlerësuar kështu burimet e financimit.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

- Siç paraqitet në shënimin 3 Donacionet dhe kontributet ne te holla „SP ka pranuar prej personave fizik shuma ne te para te gatshme ne vlerë mbi 1000 euro brenda një date prej te njëjtit person, qe benë shkelje të Ligjit 03/L-196. Me datën 28.10.2016 dhe me datën 31.11.2016 janë pranuar si donacion ne te holla përmes llogarisë bankare prej personave fizik ne shuma mbi 1,000.00 euro.
- Subjekti Politik për blerjet e kryera ,jo ne të gjitha rastet ka aplikuar procedurat te tenderimit, ku do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një

anomalië materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Nijazi Jakupi
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2016
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	2,224.06	3,609.04
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		2,224.06	3,609.04
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	70.88	0.00
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		70.88	0.00
Total pasuritë		2,294.94	3,609.04
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar			0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		(29,843.55)	(24,375.38)
Total Ekuiteti		(29,843.55)	(24,375.38)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	2	2,224.06	3,609.04
Gjithsej detyrimet afatgjata		2,224.06	3,609.04
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	4	14,670.06	10,671.31
Detyrimet tjera afatshkurtra	5	15,244.37	13,704.07
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		29,914.43	24,375.38
Gjithsej detyrimet		32,138.49	27,984.42
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		2,294.94	3,609.04

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

Viti që përfundon me 31 Dhjetor			
	Shënimi	2016	2015
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		189,000.00	179,800.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	6	10,900.00	5,805.50
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	7	6,620.00	6,315.86
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	2	452.31	751.79
Të hyrat tjera			1,758.90
Gjithsej të hyrat për vitin		206,972.31	194,432.05
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	8	105,204.23	114,140.39
Shpenzimet e transportit	8	10,003.66	16,871.70
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	8	30,797.49	14,029.54
Shpenzimet e fushatës	8	11,033.24	0.00
Blerja e mallrave	8	45.00	1,185.00
Shpenzimet e përgjithshme	8	70,200.58	65,585.71
Shpenzimet e ndryshme	8	9,531.66	6,995.09
Gjithsej shpenzimet për vitin		236,815.86	218,807.43
Suficiti / (deficiti) për vitin		(29,843.55)	(24,375.38)

1. Informata te përgjithshme

NISMA për Kosovën është subjekt politik i certifikuar nga KQZ-ja.

Udhëheqja: Fatmir Limaj (Kryetar i partisë)
Selia : Rr “Mujo Ulqinaku” nr. 18 – qyteza Pejton
Numri fiskal : 601132757
Përfaqësuesi i autorizuar financiar : Faton Thaçi

Pasqyrat financiare të SP NISMA për Kosovën janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nën 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari të vetme bankare në bankën NLB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

Përshkrimi	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////////////////////		0.00
Objektet					0.00
Veturat					0.00
Pajisjet e zyrës	2,845.21	0.00	621.06	370.69	1,853.46
Pajisjet e teknologjisë informative	224.84	0.00	149.90	18.74	56.20
Pajisjet tjera	538.99	0.00	161.71	62.88	314.40
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	3,609.04	0.00	932.67	452.31	2,224.06

Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Paraja në bankë	70.88	0.00
Paraja në arkë		0.00
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	70.88	0.00

Shënimi 4. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Europrinty	12,793.70	6,501.67
HIB Petroll	1,753.52	2,761.81
KEDS	0.00	74.09
AGRO KOP	0.00	900.00
Llogari të pagueshme të tjera	122.84	433.74
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	14,670.06	10,671.31

Shënimi 5. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	8,598.21	1,164.01
Detyrimet për qira	6,646.16	12,540.06
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrimet tjera afatshkurtra		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	15,244.37	13,704.07

Shënimi 6: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Valdete Bajrami	Prishtine		06.01.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		06.01.2016	40.00	40.00	0.00
Eshref Vishi	Ferizaj		21.01.2016	100.00	100.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		03.02.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		03.02.2016	40.00	40.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		07.03.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		07.03.2016	40.00	40.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		05.04.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		05.04.2016	40.00	40.00	0.00
Eshref Vishi	Ferizaj		04.05.2016	100.00	100.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		05.05.2016	100.00	100.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		01.06.2016	200.00	200.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		01.07.2016	200.00	200.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		01.08.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		01.08.2016	40.00	40.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		05.09.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		05.09.2016	40.00	40.00	0.00
Eshref Vishi	Ferizaj		09.09.2016	100.00	100.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		03.10.2016	160.00	160.00	0.00
Illir Bajrami	Gjilan		03.10.2016	40.00	40.00	0.00
Jakup Krasniqi	Prishtine		27.10.2016	1,000.00	1,000.00	0.00
Muharrem Kuqi	Prishtine		28.10.2016	2,000.00	2,000.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		01.11.2016	160.00	160.00	0.00

NISMA per Kosoven

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

Ilir Bajrami	Gjilan		01.11.2016	40.00	40.00	0.00
Skender rcica	Prishtine		29.11.2016	1,000.00	1,000.00	0.00
Jakup Krasniqi	Prishtine		29.11.2016	1,000.00	1,000.00	0.00
Dardan Krasniqi	Prishtine		30.11.2016	500.00	500.00	0.00
Behar Amerllahu	Lipjan		30.11.2016	1,700.00	1,700.00	0.00
Valdete Bajrami	Prishtine		01.12.2016	160.00	160.00	0.00
Ilir Bajrami	Gjilan		01.12.2016	40.00	40.00	0.00
Enver Hoti	Malisheve		02.12.2016	1,000.00	1,000.00	0.00
Eshref Vishi	Ferizaj		20.12.2016	100.00	100.00	0.00
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				10,900.00	10,900.00	0.00

Shënimi 7: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Shërbime reklamuese	SH.PK. ORANGE	Xheladin Hana	601148796	28.11.2016	1,920.00
kamera gjate fushatës	A.M.C NSH	Lagja Univerziteti Nr.47 Pr	600857083	28.11.2016	1,000.00
kamera gjate fushatës	A.M.C NSH	Lagja Univerziteti Nr.47 Pr	600857083	02.12.2016	800.00
kamera gjate fushatës	A.M.C NSH	Lagja Univerziteti Nr.47 Pr	600857083	16.12.2016	600.00
e votimit 04 dhe 18-12.00	Te Parku	Malisheve	600336954	18.12.2016	2,300.00
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					6,620.00

Shënimi 8: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	91,183.40	83,733.40	7,450.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	5,004.63	4,595.19	409.44
Kontributet pensionale të punëdhënësit	5,004.65	4,595.21	409.44
Tatimet në të ardhura personale	4,011.55	3,682.22	329.33
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	105,204.23	96,606.02	8,598.21
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	6,790.80	6,790.80	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave	1,960.00	1,960.00	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	1,252.86	1,252.86	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	10,003.66	10,003.66	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	710.70	710.70	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	30,086.79	17,293.09	12,793.70
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	30,797.49	18,003.79	12,793.70
Shpenzimet e fushatës			

NISMA per Kosoven

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

Shpenzimet e fushatës	11,033.24	9,156.88	1,876.36
Gjithsej shpenzimet e fushatës	11,033.24	9,156.88	1,876.36
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	45.00	45.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	45.00	45.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	59,635.21	52,989.05	6,646.16
Telefoni, interneti dhe posta	4,768.65	4,768.65	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	5,344.41	5,344.41	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	452.31	//////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		//////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	70,200.58	63,102.11	6,646.16
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	2,100.00	2,100.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	7,431.66	7,431.66	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	9,531.66	9,531.66	0.00
Gjithsej shpenzimet	236,815.86	206,449.12	29,914.43